

AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VLORA NET” SHPK

Sot, më datë 30/01/2025 personi i poshtëshënuar:

- **Eno Veshi**, lindur më 17/05/1982 në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal I205170720, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

VENDOSI:

NENI 1

Me vullnet të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“VLORA NET” sh.p.k.**

NENI 2

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Vlorë, Rruga “Aleksandër Moisiu”, Hyrja 1, Zona Kadastrale Nr. 8602, Sipërfaqe 145 m².

Shoqëria mund të hapë dhe mbyll zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda dhe/ose jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç selisë së Shoqërisë.

NENI 3

Objekti i shoqërisë do të konsistojë në:

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: Operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhënash/internet, IP TV, VoIP. Shërbime të linjave me qera. Aktiviteti i tregtimit me shumicë dhe pakicë dhe import-eksport të makinerive, paisjeve e veglave të fushës së telekomunikacionit. Import eksport për mallra të ndryshme për nevoja të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Ritransmetim media audiovizive bazuar në kabëll koaksial dhe/ose fibër optike. Ritransmetim media audiovizive nëpërmjet internetit. Ritransmetim media audiovizive nëpërmjet satelitit.

NENI 4

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000.000 (dhjetë milionë) Lekë.
Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortaku” i shoqërisë :

Ortaku themelues: Eno Veshi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000.000 (dhjetë milionë) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



2. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
3. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
4. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 5

Organet drejtuese dhe vendimarrëse të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm.
2. Administratori.

Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin dhe ligjet në fuqi.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e shoqërisë me përjashtim të atyre që nevojitet miratimi nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm.

NENI 6

1. Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi. Nëse Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

2. Administrator i kësaj shoqërie me mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi do të jetë:

Ersida Kasma, lindur më 10.01.1986 në Gjirokastrë dhe banuese në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal I651100790, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

NENI 7

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 8

Ky akt themelimi është hartuar në gjuhën shqipe në 3 kopje me të njëjtën fuqi ligjore.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, Dt. 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar si dhe legjisllacionit në fuqi.

Nënshkruar, më datë 30/01/2025.

ORTAKU THEMELUES

Eno Veshi



